

Edukimi për drejtësi shoqërore

(Aktivitete për të rritur dhe fëmijë)

Qëllimet e programit:

Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit do të:

- Thellojnë njohuritë, të kuptuarit dhe ndjeshmërinë për mekanizmat që përjetësojnë dhe mbajnë sistemet e dominimit
- Ndërtojnë përkushtimin ndaj procesit të ndërtimit të kapacitetit për transformim personal, profesional dhe institucional
- Përforcojnë vetë-konceptin e fëmijëve dhe identitetet grupore duke pranuar, respektuar dhe afirmuar të gjitha kulturat dhe përvojat e fëmijëve
- Përforcojnë marrëdhëniet e shkollës me familjet dhe komunitetet duke i inkuadruar në materialin mësimor, si bazë për mësimin e njohurive dhe shkathtësive të reja, që vijnë drejtpërdrejtë nga familjet dhe komunitetet
- Nxisin fëmijët të hulumtojnë dhe kërkojnë zgjidhje për padrejtësitë shoqërore të cilat ata mund t'i hasin.
- Mësojnë si të nxisin të menduarit kritik të fëmijët, rreth keqinterpretimeve, stereotipeve dhe paragjykimeve.
- Jenë me të hapur për të përfshirë grupet e ndryshme etnike gjejnë forma dhe sugjerime se si të lehtësohet ky proces.

Përmbajtja

Programi Edukimi për Drejtësi Shoqërore është një program trajnimi i cili ka për qëllim krijimin e vetëdijes kritike për të njohur diversitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik, si vlerë njerëzore. Pranimi i të tjerëve pa paragjykime, të qenit tolerant dhe i hapur, janë sjellje thelbësore të çdo qytetari, si dhe kusht për krijimin e një shoqërie demokratike. Një qasje

e tillë i mundëson çdo qytetari të drejtën për të qenë i pranuar dhe i trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, në aspektin individual, shoqëror dhe institucional.

Shkathtësitë e mësuara në trajnim ndërtohen mbi Standardet Pedagogjike të ISSA për: individualizimin për të vlerësuar diversitetin në mesin e nxënësve dhe familjeve; pjesëmarrjen e familjes; krijimin e ambienteve mësimore gjithëpërfshirëse; hartimin dhe zbatimin e strategjive të ndryshme mësimore që promovojnë bashkëpunimin: hulumtimin dhe zgjidhjen e problemeve si dhe planifikimin dhe vlerësimin e mësimnxënies.

Programi **Edukimi për Drejtësi shoqërore** do të zgjerojë dhe thellojë njohuritë në këto fusha duke i prezantuar strategjitë për:

- zhvillimin e aftësive për të menduar në mënyrë kritike për ta kuptuar realitetin në formë të drejtë dhe angazhimin që duhet bërë për luftimin e padrejtësive
- njohur nivelet e ndryshme të përgjegjësisë në përjetimin e dominimit sistematik
- ndihmë në transformimin e ambientit të tyre personal, profesional dhe institucional
- zhvillimin e marrëdhënieve me familjet dhe komunitetet që tradicionalisht janë të marginalizuara në sistemin shkollor
- përfshirjen e zërit të fëmijëve dhe familjeve në hartimin e programeve
- promovimin e kapacitetit të nxënësve për bashkëpunim, negociata dhe mendim kritik duke u siguruar nxënësve mundësi për të përfituar përvojë përmes një llojllojshmërie perspektivash dhe duke modeluar respekt për këndvështrime të ndryshme
- zhvillimin e njësive dhe aktiviteteve të integruara që i adresojnë apo inkorporojnë çështjet e drejtësisë shoqërore duke përdorur tema që janë pjesë e kurrikuleve kombëtare, tregime të zakonshme të fëmijëve dhe tema të cilat i iniciojnë fëmijët nga interesat dhe përvojat e tyre (për shembull, drejtësia, përfshirja, bashkëpunimi, si të zgjidhet konflikti dhe ndërprerja e stereotipeve negative); nxënësit gjithashtu mësojnë shkathtësi akademike të përshtatshme për moshën e tyre

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet punëtorëve të arsimit dhe të gjithë atyre që kanë dëshirë t'i thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për relacionet njerëzore si dhe t'i njoftojnë fëmijët me dallimet shoqërore.

Forma e organizimit/kohëzgjatja

Programi prezantohet në formë të trajnimit katërditor me gjithsej 32 orë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është vijueshmëria e plotë e 90% të trajnimit